

STATUT I SHOQËRISË
“EVIA20” SHPK

Ne Tirane, sot me date 24.06.2020 unë Ina Hoxha, e bija e Ylli-t, e datelindjes 20.11.1990, lindur në Fier dhe banues në Patos, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e indentifikuar prej leternjoftimit me nr. Personal J06120025R, ne cilesine e “ortakut themelues“ deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj statutin e shoqerise ‘**EVIA20**’ **SHPK**

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria “**EVIA20**” **SHPK**, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e sajne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**EVIA20**” sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e cila ushtron aktivitetin e saj tregtar në përputhje me këtë Statut dhe rendin juridik në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria “**EVIA20**” sh.p.k, është titullare e të drejtave subjektive dhe mbajtëse e detyrimeve juridike.

Ortakët përgjigjen personalisht për detyrimet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Çdo ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

NENI 3

SELIA

Selia e Shoqerise ne adresen: Rruga Fier-Zharres, km 10, Zona Kadastrale Nr.3922, Numri I pasurise 118/24, Fier, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda



ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm.

NENI 4 KOHEZGJATJA

Shoqëria "EVIA20" sh.p.k do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

Shoqëria mund të shpërndahet përpara këtij afati vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 5 OBJEKTI

Objekti I shoqerise do te konsistoje ne :

Tregti me shumice, pakice, import-eksport, mirembajtje, montim, sherbim per produkte dhe pajisje per fushen: Elektrike, Elektronike, Industriale, bujqesore, mobilimi, hidrisanitare, lavanteri, kancelari, ndertim, hidraulike dhe produkte per ujesjellsa, pajisje sigurie dhe kundra zjarrarit etj. Laboratore mjeksore, industriale dhe agrokulturale. Mobilim universitete, shkolla, zyra laboratore, spitale, hotele, burgje, porte dhe aeroporte, salla konferencash, teatro, stadium, etj. Tregti me shumice e pakice, import-eksport I detergjenteve te pastrimit, reagenteve dhe produkteve ushqimore, tekstile dhe veshje te ndryshme. Organizime eventesh dhe sherbime katering .

Per kete qellim Shoqeria mund te veproje si ne Shqiperi dhe jashte vendit. Kompania gjithashtu mund te veproje nepermjet filialeve te saj apo te shoqerive te kontrolluara prej saj. E gjithë kjo ne respektim te legjislacionit qe rregullon ceshtjet specifike te listuare me siper, ndalimet, kufizimet dhe kerkesat ligjore dhe prandaj i nenshtrohen lejeve, autorizimeve dhe rregjistrimeve qe mund te jene te nevojshme me perputhje me te gjithë kushtet e tjera.

Shoqeria mundet se fundi ne menyre industriale te kryej cdo veprim tregtrar ne lidhje me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme. Gjithashtu shoqeria mund te kryej cdo aktivitet tjeter biznesi I cili nuk eshte I ndaluar nga ligji I zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.

NENI 6 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne vleren 100.000 (njqindmije) leke, Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise **Znj.Ina Hoxha** dhe perbet nga 1 (nje) pjese/kuote me vlere te pergjithshme **100.000 (njqind mije) leke**, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kuotat jane te zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve te parashikuara ne ligj dhe ne Statut.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.



NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

NENI 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave të të tretet kufizohet me miratim të asamblese së ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

KREU II

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërise.

Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërise që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Z.Olivjo PLEPI**, i biri i Shkelqim-it, lindur me 19.03.2000 ne Fier dhe me banim ne Fier, identifikuar nepermjet Leternjoftim me Nr.Personal K00319022G, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Afati i emerimit te administratorit eshte per nje periudhe 5(pese) vjecare.

Administratori mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë



së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë Z.Olivjo PLEPI, ka të drejtë që të realizojë vetëm derdhje në llogarite bankare të Shoqërisë, por nuk ka drejtë të realizojë transferta, terheqje apo çdo lloj veprimi tjetër në këto llogari.

Vetëm personi i pajisur me autorizim (Prokure e Posaçme) nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Ina HOXHA ka të drejtë të realizojë transferta, terheqje apo çdo lloj veprimi tjetër në llogarite bankare të Shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me pergjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, pergjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata pergjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare,



duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
d) jep kredi.

NENI 13

VITI USHTRIMOR FINANCIAR

Viti ushtrimor financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin
Tregtar dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

Neni 14

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

NENI 16

LIKUIDIMI

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

NENI 17

SHPËRNADRJA/PRISHJA

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19

TË DREJTAT E DETYRIMET E LIKUIDUESIT

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

PËRFUNDIMI I LIKUIDIMIT

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 21

BASHKIMI

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

NDARJA

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b) bërjen e aksionarëve/ortakut të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën

Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

SHNDERRIMI

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

MOSMARREVESHJET

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortakët themelues.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ‘EVIA20’ Sh.p.k

INA YLLI HOXHA

Ina Ylli Hoxha